


HIDRO IZOLUESIT



AQUABLOCK

Ngjyra	Paketimi
Gri	Ambalazh Plastik 2 Kg

PËRSHKRIM

Lidhës hidraulik pluhur i përbërë nga çimento special me rezistencë të lartë. Për sipërfaqe horizontale dhe vertikale pa patur rrëshkitshmëri. Koha e tharjes së produktit është rreth 1 minutë e 20 sekonda në kushte optimale temperaturash. Pas ngurtësimit, produkti fiton rezistencë të lartë mekanike brenda një kohë shumë të shkurtër pas 1-2 orësh. I papërshkueshëm dhe rezistent ndaj ujit.

FUSHA E APLIKIMIT

Bllokimi i rrjedhjeve të ujërave edhe në prani të presionit të lartë.

- Ndalimi i rrjedhjeve të ujit në bodrume dhe në të gjitha strukturat nëntokësore.
- Ndalimi i rrjedhjeve të ujit në rezervuarët mbi tokë.
- Bllokimi i rrjedhjeve të ujërave në çarjet midis tavaneve dhe mureve.
- Bllokimi i rrjedhjeve të ujërave në çdo tip çarje dhe vrimave.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vavra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pas-trohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike me fshesë.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përzieni rreth 300 gr ujë të pastër me 1 kg AQUABLOCK me dorë ose me mistri, derisa të arrini një masë homog-jene dhe pa kokrriza. Duke patur parasysh tharjen e shpe-jtë rreth 1 min përzieni produktin në sasira të vogla.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Jepini produktit me duar formën e një tape. Prisni disa sekonda derisa produkti të fillojë të thahet dhe vendoseni mbi të çarat, mbajeni të presuar për rreth 1-2 minuta. Hiqni materialin e tepërt me një fresibël ose një letër zmerile. Për aplikime për fuga të mëdha, përzieni produktin me rërë të ashpër (deri në 1.5 mm) në raportin 1:3 ose 1:4.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Ujë për përzierje: 30% e masës së AQUABLOCK
Paketimi: Ambalazh plastik 2 kg	pH i perzierjes: 12
Ngjyra: Gri	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Konsumi: 1.2 kg /m ² /mm trashësi	Rezistenca në shtypje (30 minuta): ≥10 N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Rezistenca në shtypje (28 ditë): >30 N/mm ²
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Rezistenca në përkulje (28 ditë): >6 N/mm ²
Masa Vëllimore: 1.3gr/cm ³	

